



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 5 mars 2012
Nr. ref.: KK-SP 37/3/12

**UDHËZIM MBI PRAKTIKAT
Nr. 01/2012
Mbi udhëzimet dhe procedurat për
PARAQITJEN E PARASHTRESAVE TË *AMICUS CURIAE***

Rregulli 53 i Rregullores së punës për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës
parasheh:

Amicus Curiae

Gjykata, nëse e konsideron të nevojshme për qëllim të analizave të duhura dhe për të vendosur për rastin, mund të thërrasë ose t'i sigurojë leje një organizate ose personi për t'u paraqitur para saj dhe për të dhënë deklaratë me gojë ose me shkrim për ndonjë çështje të specifikuar nga Gjykata.

PARAQITJA E PARASHTRESAVE TË *AMICUS CURIAE*

1. Kërkesat për leje të paraqitjes së parashtresave *amicus* mund të dorëzohen të pa kërkuara ose si përgjigje ndaj ftesës së Gjykatës dhe në diskrecionin ekskluziv të Gjykatës. *Amici* mund të ftohet për pjesëmarrje në diskutim me gojë në diskrecion të Gjykatës.
2. Në diskrecionin e vet, Gjykata mund të kërkojë një *amicus* parashtresë nga një organizatë apo person, lidhur me ndonjë prapavijë të përgjithshme faktike ose lidhur me ndonjë çështje ligjore apo aspekt ligjor të çështjes që është objekt shqyrtimi.
3. Kërkesa për leje të paraqitjes së *amicus* parashtresave, duhet të dorëzohet jo më vonë se 15 ditë pas afatit të paraparë që pala kundërshtarë të përgjigjet ndaj kërkesës. Për një arsye të fortë, Gjykata mund të lejojë parashtrimin edhe më vonë.
4. Organizatat ose personat që dëshirojnë të paraqesin një *amicus* parashtresë, apo të paraqiten si *amicus curiae*, duhet të parashtrorjnë kërkesë duke saktësuar si vijon:
 - a) Emrin e parashtruesit të kërkesës, adresën dhe interesimi në rast;
 - b) Çështjen apo çështjet që parashtruesi i kërkesës dëshiron t'i adresojë, dhe natyrën e informacionit apo analizat që parashtruesi i kërkesës propozon të dorëzohen;
 - c) Kualifikimet e parashtruesit të kërkesës;
 - d) Nëse parashtruesi i kërkesës aplikon për leje të paraqes parashtresë *amicus* apo të paraqitet si *amicus curiae*:
 - i) lidhur me ftesën e përgjithshme për kërkesa nga Gjykata; ose

- ii) me iniciativën e vet parashtruesit të kërkesës.
- e) Arsyet e parashtruesit të kërkesës pse beson që parashtrësia e tij do të ndihmojë në vendimin e drejtë të rastit apo çështjes;
- f) Deklaratë me të cilën identifikohet apo sqarohet çfarëdo kontakti apo lidhje që parashtruesi i kërkesës kishte ose ka me cilëndo palë të rastit.

5. Parashtruesit duhet të kenë parasysh si vijon:

- a) Në të gjitha rastet, parashtrësia *amicus* duhet bërë me shkrim. Përsëri, *amici* mund të ftohet për pjesëmarrje në diskutim gojor në diskrecionin ekskluziv të Gjykatës;
 - b) Në përgjithësi, parashtrësia *amicus* duhet të kufizohet në çështjet e ligjit;
 - c) Nëse Gjykata kërkon apo fton parashtrësia *amicus curiae*, duhet t'u japë palëve mundësinë për të kundërshtuar parashtrësia *amicus*, dhe në çfarëdo rasti duhet të mbajë të drejtën për të refuzuar parashtrësien e ofruar;
 - d) Gjykata duhet të përcaktojë kohën për parashtrësia *amicus* dhe mund të caktojë kufizim faqesh lidhur me gjatësinë e parashtrësive të tilla;
 - e) Palëve do t'u jepet mundësia të komentojnë për parashtrësia *amicus*, si kanë qenë të pranuar, por *amici* nuk do të jenë çështje e pyetjeve nga palët;
 - f) Komentet duhet të paraqiten brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të parashtrësies *amicus*. Komentet duhet t'u dorëzohen të gjitha palëve dhe *amicus curiae*;
 - g) Në përgjithësi, *amici curiae* do të bartin shpenzimet e veta, por nëse *amicus* ka qenë ftuar posaçërisht për të parashtruar apo për t'u paraqitur, Gjykata mund të autorizojë Sekretaren e Përgjithshme për kompensimin e shpenzimeve të arsyeshme të shkaktuara lidhur me pjesëmarrjen në procedurat në Gjykatë.
6. Kërkesa duhet t'i dërgohet Sekretares së Përgjithshme (shih pikën 7, më poshtë) e cila më pastaj do t'i përcillet Gjykatës për vendim në përputhshmëri me rregullin 53 të Rregullores së punës. Kërkesa mund të shoqërohet me parashtrësë me shkrim *amicus*, të cilën parashtruesi kërkon ta pranojë Gjykata.

7. Parashtruesit e kërkesës duhet t'i drejtohen:

Sekretarit të Përgjithshëm
Rruga "Perandori Justinian" p.n; 10000,
Prishtinë, Kosovë

Ky Udhëzim procedural do të hyjë në fuqi më 5 mars 2012.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

